



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 153/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Zyhdhi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vodosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), që të dyja me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes se posterit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**PRANOHEN** të bazuara ankesat Anr. 153/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe ankesa Anr. 161/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), të dyja me seli në Prishtinë, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, i SHQIPOHET gjobë në lartësi prej 2,900.00 (dymijë e nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 01.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.153/2019, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe ankesën Anr.161/2019, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), të dyja me seli në Prishtinë, të paraqitura kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilat pretendohet se kanë vërejtur një poster të kandidatit për deputet nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosoves (PDK), Novitet Nezaj, të vodosur mbi rrugë publike në një fshatin Gjonaj të Hasit. Komuna e Prizrenit. Paraqitësit e ankesave më tutje theksojnë se subjekti politik PDK, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, perkatesisht nenin 33 pikë b), dhe me Rregullat zgjedhore 11/2013 dhe 13/2013.

Paraqitësit e ankesave, si dëshmi për pretendimet e tyre, ankesave të paraqitura u kanë bashkangjitur nga një fotografi për rastin në fjalë.

Paneli, në bazë të nenit 13 paragrafi 2, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vodosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të datës 02.10.2019, ka theksuar se vendosja është bërë nga simpatizantët e pa informuar për Rregullat Zgjedhore. Më tutje subjekti politik (PDK), deklaron se janë marrë masa përmirsuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 2, të LZP-së, gjeti se:

**Ankesat janë të bazuara, për këto arsyë:**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është ngjitur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b), të LZP-së, e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është shkelur nen 33 pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik (PDK), është vendosur mbi rrugë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me Rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatit për deputet të këtij subjekti politik është vendosur mbi rrugë publike.

Si rrethanë PZAP-i, morri edhe faktin që subjekti politik PDK, në përgjigjen në ankesë, ka deklaruar se janë marrë masa përmirsuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje. Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse sipas nenit 3 paragrafi 2 i Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2012, shkeljet e kësaj natyre të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mund te shqiptohet gjobë subjektit

politik nga 5,100.00 euro deri në 20,000.00 euro, për subjektet politike që kanë qenë te përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mirëpo siç u konstatua me lart, veprimet e subjektit politik PDK, për ta përmirësuar shkeljen, ka ndikuar në uljen e lartësisë e gjobës.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1, pika c) dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë**

Anr.153/2019 më datë 04.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**

Fejzullah Rexhepi



*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.*